dekonta

SHËRBIMET DHE PRODUKTET PËR NJË MJEDIS MË TË MIRË



PROFILI I KOMPANISË

DEKONTA është kompani mjedisore lider në Europën Qëndrore / Lindore. Ajo ofron shërbimet dhe produktet në vijim:

- Studimin dhe rehabilitimin e zonave të kontaminuara
- Trajtimin e mbetjeve të rrezikshme
- Përgjigje imediate ndaj cështjeve mjedisore
- Demolim, dekomisionim dhe pastrim teknollogjik
- Konsulencë mjedisore
- Monitorim mjedisor dhe shërbime laboratorike
- Pajisje për trajtimin e shkarkimeve industriale të lëngëta dhe të gazta
- Zhvillim dhe kërkim mjedisor

DEKONTA në shifra:

- Krijuar në vitin **1992** në Republikën Ceke
- Staf i përbërë nga **150** anëtarë të kualifikuar dhe me eksperiencë (**80**% me diplomë universitare, **10**% me doktoraturë)
- Xhiro vjetore afërsisht **20** milion Euro
- Rreth **400** projekte mjedisore të shpërndara në **10** shtete cdo vit
- Kompani e certifikuar sipas ISO **9001**, ISO **14001** dhe OHSAS **18001**
- Zyra në 7 shtete: Republika Ceke, Hungari, Poloni, Rumani, Rusi, Serbi dhe Sllovaki



PERSONELI, PAJISJET DHE FACILITETET

- Ekip multidisiplinar (kimi / gjeologji / biologji / inxhinieri / inxhinieri ndërtimi / inxhinieri elektrike / inxhinieri mjedisore / ekologji / bujqësi / juridik / ekonomi)
- Ekspertë dhe menaxherë projektesh me eksperiencë ndërkombëtare
- Disponon pajisje dhe ofron shërbime për:
  - Rehabilitimin e zonave të kontaminuara me përdorimin e metodave fizike, kimike dhe bioteknologjike
  - Studimin ne terren e nepermjet – shpime / marrje e mostrave / matje dhe testime në zonë
  - Grumbullimin, transportimin dhe trajtimin e mbetjeve
  - Përgjigje mjedisore imediate 7ditë/javë – 24 orë/ditë
- Ambjente riparimi, magazinimi dhe ruajtje
- 20 ambiente të bio- trajtimit në Europë
- Laboratore kimike, mikrobiologjike dhe teknike
- Qëndër kërkimi mjedisore
- Hardware dhe Software të përditësuar, për grumbullimin, vlerësimin, modelimin vizual dhe matematikor të të dhënave

REHABILITIMI I ZONAVE TË KONTAMINUARA

DEKONTA ka pastruar me sukses qindra zona të kontaminuara nga ndotës të ndryshëm organik dhe inorganik në disa vende. Në varësi të natyrës së ndotjes dhe kushteve specifike të zonës, aplikohet rehabilitimi më i përshtatshëm. Metodat bazë të përdorura janë dy:

- Rehabilitimi "Ex situ" – gërmim i tokës së kontaminuar ose pompimi i ujërave nëntokësore të kontaminuara dhe trajtimi i mëtejshëm
- Rehabilitimi "In situ" – Pastrimi nga ndotja i tokës dhe/ose ujërave nëntokësorë direkt në zonën ku ka ndodhur ndotja (pa pompim ose gërmim)

DEKONTA zotëron njohurite eksperiencën, materialet dhe pajisjet e domosdoshme për aplikim të suksesshëm të metodave të rehabilitimit si më poshtë:

FIZIKE	KIMIKE	BIOLOGJIK	TË TJERA
Dhera / Mbetje:	**Dhera / Mbetje:**	**Dhera / Mbetje:**	**Dhera / Mbetje:**
Thërmim, ekzaminim dhe klasifikim Ngurtësim/stabilizim Ekstraktim me avull Larje Djegie Desorbim termik	Oksidim kimik Reduktim kimik Neutralizim	Biorehabilitim Bioventing Fito-rehabilitimi	Depozitimi në landfill Ripërpunimi Ndërtimi i strukturave speciale për izolimin e lëndëve ndotëese Mbulimi
Ujërat nëntokësore:	**Ujërat nëntokësore:**	**Ujërat nënëtokëore:**	**Ujërat nëntokësore:**
Gurgullim ajri Pompim dhe trajtim i mëtejshëm nëpërmjet: ▪ Ndarjes sipas gravitetit ▪ Stripping (Largimi nga uji i një ose më tepër i perberjeve kimike të adsorbimit) ▪ Koagulimit ▪ Flokulimit ▪ Osmosa inverse	Oksidim kimik Reduktim kimik Neutralizim	Biorehabilitim Deklorifikimi biologjik Reduktimi biologjik Bio-slurping (kombinim i vakumit me ajrimin)	Barrierat hidraulike Barrierat reaktive Perde penguese betoni nëntokësore

STUDIMI, MARRJA E MOSTRAVE DHE MONITORIMI NË TERREN

DEKONTA ka eksperiencë të gjërë në aktivitetet kërkimore në terren si dhe në marrjen e mostrave dhe monitorimin e komponentëve mjedisorë ne:

- Dhera
- Mbetje
- Mbetje ndërtimi
- Llumra dhe sedimente
- Ujëra nëntokësorë
- Ujëra sipërfaqësorë
- Gazin e tokës
- Ajrin

DEKONTA zotëron staf të kualifikuar dhe të disponueshëm, leje, akreditime, certifikata, pajisje dhe materialet e domosdoshme për kërkime, marrjen e mostrave, aktivitete monitorimi, përfshire pajisje shpimi, pajisje shpimi manuale, tipe të ndryshme për marrjen e mostrave, pompa, pajisje për analiza dhe matje në terren, regjistruese elektronik të të dhënave, pajisje, kontenierë për mostrat e marra, kontenier me ftohje për ruajtjen dhe transportimin e mostrave, mjete për pastrimin dhe dezifektimin e pajisjeve të përdorura në marrjen e mostrave, etj.

ANALIZAT NË TERREN DHE LABORATORET E LËVIZSHËM

Spektometri Raman

Pajisje unike për përdorim në terren që mundëson identifikimin e mbi 6000 substancave organike dhe inorganike dhe përbërësve përkatës, duke përfshirë eksplozivëve dhe lëndë narkotike.

Analizuesi manual DELTA XRF

Kjo pajisje e përditësuar për matje në terren, siguron informacion të menjëhershëm rreth përbërjes së metaleve toksike dhe ndotësve të tjerë në tokat dhe sedimentet e kontaminuara.

Ecosonde 5

Pajisje fleksibël dhe e sigurt për zbulimin në terren dhe analizat e VOC (Volatil Organic Compaunds/Lëndëve Organike Fluturuese). Ndërthur analizuesin PID (Photoionization gas sensor) për matjen e përqëndrimit total të gazit të tokës dhe analizuesin selektiv IR (Infrared) për matjet vecamas të metanit, hidrokarbureve të naftës dhe dioksidit të karbonit.

Bazuar në kërkesat e klientëve, DEKONTA mund të përgatisë laboratorë te instaluar ne kontenierë të lëvizshëm, të pajisur për aktivitete specifik:

- Laborator analitik
- Laborator mikrobiologjik
- Laborator për përgatitjen e mostrave

Laboratori i lëvizshëm mund të jepet me qera, ose mund të vihet ne dispozicion nga vet kompania së bashku me stafin e specializuar.

PUNIMET E SHPIMIT

Duke operuar me pajisjet e saj të shpimit (Sondë AMS, JaNo) DEKONTA ofron shërbimet si më poshtë vijojnë:

- Shpim me shtytje direkte (grumbullim i paprishur i mostrave të dheut nga niveli i përzgjedhur i thellësisë së tokës)
- Shpim me rrotullim
- Monitorim i përkohshëm ose i përhershëm i puseve
- Injektimi në puse për aplikimin e metodave të rehabilitimit kimik dhe biologjik “in situ” Teste penetrimi (depërtimi)
- Shpime eksplorative
- Shpime për pompat e nxehtësisë
- Metoda për mbrojtien nga rrëshqitjet e tokës

MONITORIMI I SHKARKIMEVE NË AJËR

DEKONTA ofron matje të akredituara të shkarkimeve në ajër dhe monitorim të cilësisë së ajrit, falë personelit me kualifikim dhe me eksperiencë të lartë si dhe falë pajisjeve të teknikës më të fundit dhe të përditësuara.
Stafi i monitorimit të ajrit në DEKONTA, garanton fleksibilitet dhe shërbime të cilësisë më të lartë në Republikën Ceke dhe jashtë vendit.

Qëllimi i shërbimeve të ofruara përfshin:

- Monitorim i autorizuar i burimeve stacionare të shkarkimeve në ajer
- Matje teknike të shkarkimeve në ajer
- Matje teknike e cilësisë së ajrit të ambientit
- Matje në terren e cilësisë së gazit të tokës



SHËRBIMET E EMERGJENCAVE MJEDISORE

DEKONTA garanton shërbime emergjence në rastet e shkarkimeve aksidentale të kimikateve toksike dhe të dëmshme në mjedis. Shërbimi në fjalë mbulon një gamë komplekse aktivitetesh duke filluar nga ndërhyrjet primare të fokusuara në eleminimin e shpërndarjes së kimikateve të shkarkuara aksidentalisht, deri në rehabilitimin total të zonës

Përgjigja ndaj emergjencave mjedisore garantohet 7ditë/javë – 24 orë/ditë në të gjithë territorin e Republikës Ceke. Numri i telefonit në rast emergjence është +420 602 686 622. Grupi i gatshëm i rasteve të emergjencës mobilizohet brenda 30 minutave nga marrja e informacionit rreth një aksidenti.

Kompania DEKONTA është e përfshirë në Sistemin e Integruar të Emergjencave të Republikës Ceke dhe bashkëpunon me Ministrinë e Brendshme nëpërmjet Selisë së Shërbimit të Shpëtimit nga Zjarri në Republikën Ceke.

Pajisjet

- Makina emergjence (Land Rovers)
- Motovarka emergjence
- Eskavatorë
- Kamiona
- Autocisterna ADR
- Pompa për substanca të rrezikshme dhe eksplozive
- Pajisje mbrojtëse për manovrimin me substanca toksike
- Pajisje dezifenktimi
- Detektor për substancat kimike
- Bazë të dhënash elektronike për substancat e rrezikshme

Shërbimi është përfshirë në sistemin TRINS (Transport Information and Accident System – Sistemi i Informacionit te Trasnportit dhe Aksidenteve) dhe Sistemit të Emergjencave dhe Sigurisë në kryeqytetin Pragë.

MENAXHIMI I MBETJEVE

DEKONTA garanton shërbime komplekse në fushën e trajtimit dhe depozitimit të mbetjeve të rrezikshme.
Në fushën e trajtimit bioteknologjik të mbetjeve të rrezikshme, DEKONTA është një kompani lider në Republikën Ceke dhe në vende të tjera të Europës Qëndrore / Lindore ku ajo operon me më shumë se 20 qendra biotrajtimi.



Aktivitete të tjera në fushën e menaxhimit të mbetjeve të rrezikshme përfshijnë:

- Përpunim i mbetjeve në lëndë djegëse alternative
- Riciklimi i mbetjeve industriale
- Ngurtësim / stabilizim i llumrave dhe pluhurave
- Dekontaminimi i mbetjeve nëpërmjet metodave fizike (ventilimi, larja, etj.)
- Dekontaminimi i mbetjeve nëpërmjet metodave kimike (oksidimit kimik)
- Trajtimi dhe depozitimi i mbetjeve nga proceset termike
- Depozitimi i mbetjeve në landfill
- Rehabilitimi dhe restaurimi i landfill-eve

Në të njëjtën kohë, DEKONTA garanton të gjitha shërbimet që kanë lidhje me nevojat dhe kërkesat e konsumatorit, duke përfshirë këtu edhe pajisjen me kontenierë për mbetjet, transportimin e mbetjeve nga konsumatori në vëndin e depozitimit, ngarkimin, peshimin, trajtimin e mbetjeve, analizat laboratorike dhe vlerësimin e rrezikshmërisë përkatëse.

SHKATËRRIM, NXJERRJE JASHTË PËRDORIMI DHE PASTRIMI TEKNOLOGJIK

DEKONTA ka realizuar një numër projektesh demontimi/demolimi dhe nxjerrje jashtë përdorimit. Përvec realizimit fizik të projekteve, aktivitetet e kompanisë përfshijnë: studime/ndërtime impiantesh, marrja e mostrave dhe analiza, projekte cmontimi/demolim, analiza riciklimi/ripërdorimi, analiza mbi transportin dhe kostot e depozitimit.

Ne garantojmë shërbimet e mëposhtme përsa i përket ndotjes nga asbesti:

- Analiza dhe studime mbi asbestin
- Largim të asbestit nga zona
- Mbledhje e mbetjeve të asbestit dhe depozitimin e tyre
- Projektimi dhe dhënia e lejes për aktivitetet për largimin asbestit

DEKONTA garanton një sërë shërbimesh të specializuara për teknologjitë e pastrimit për rafineritë, rezervuarët në ferma, impiantet energjitike, impiantet kimike dhe industri të tjera. Shërbimet tona përfshijnë në vecanti:

- Pastrimin e rezervuarëve
- Pastrimin e sistemeve të tubacioneve dhe të ujërave të zeza
- Pastrimin e pajisjeve teknologjike që e kanë mbyllur aktivitetin
- Pastrimi baseneve / rezervuarëve / liqeneve pellgjeve

SHËRBIMET LABORATORIKE DHE AKTIVITETET R&D (KËRKIM DHE ZHVILLIM)

DEKONTA garanton një gamë të gjërë analizash dhe ekzaminimesh në laboratoret e saj analitike, mikrobiologjikë dhe teknologjikë – duke përfshirë këtu:

- Analiza kimike (organike dhe inorganike) të tokës, mbetjeve, sedimenteve, llumrave, materialeve të ndërtimit, ujit, ujërave kullues dhe mostrave të ajrit/gazit
- Analiza komplekse mikrobiologjike
- Përcaktimin e ekotoksicitetit

Laboratorët analitik dhe mikrobiologjik (Usti nad Labem, Dretovice dhe Ostrava) janë të pajisura me analizatorë dhe pajisje të modernizuara. Të gjitha aktivitetet menaxhohen në përputhje me legjislacionin përkatës, standartet teknike dhe instruksionet metodologjike. Laboratorët punojnë në përputhje me kërkesat e standartit ISO/IEC 17 025.

Biopreparate për trajtimin bioteknologjik të mbetjeve të kontaminuara dhe rehabilitimin bio të zonave të kontaminuara, përgatiten në laboratorët bioteknologjik të DEKONTËS në Dretovice dhe Ostrava.

Në laboratorët tanë teknologjikë (Dretovice dhe Slany), janë zhvilluar dhe testuar metoda dhe teknologji të reja për rehabilitimin dhe trajtimin e mbetjeve.

DEKONTA shpenzon cdo vit më shumë se 1 milion EURO në fushën e kërkimeve dhe zhvillimeve për teknologji të reja mjedisore. Kompania merr pjesë në disa grante R&D Ceke dhe Europiane dhe ka krijuar lidhje të ngushta me universitetet lider Europiane dhe me institucione kërkimore në fushën e mbrojtjes së mjedisit.

SHËRBIMET E KONSULENCËS

DEKONTA garanton shërbimet e konsulecës për fushat e mëposhtme:

- Investigime në përputhje me auditimin mjedisor
- Audite mjedisore (duke përfshirë këtu audite në përputhje me protokollet/ udhëzimet e EBRD – Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe WB - Bankës Botërore)
- Studime për vlerësim të ndikimit në mjedis dhe konkluzionet e ekspertëve në lidhje me studimet përkatëse
- Aktivitete konsulence për zbatimin e Menaxhimit Cilësor (ISO 9001), Menaxhimit Mjedisor (ISO 14001) dhe Menaxhimit Shëndetësor dhe të Sigurisë (OHSAS 18001)
- Leje të integruar për IPPC - Kontrollin dhe Parandalimin e Integruar të Ndotjes, në përputhje me legjislacionin vëndas

- Studime për nivelin e zhurmave
- Studime mbi emetimet në ajër
- Plane menaxhimi mbi mbetjet
- Opinione të ekspertëve
- Studime për vlerësimin e rrezikut mjedisor dhe të shëndetit publik
- Mbështetje e plotë teknike për shërbimet mjedisore
- Supervizim (kontroll i panvarur i një pale të tretë) mbi projektet mjedisore

BIOFILTRAT

Biofiltrimi paraqitet si një zgjidhje mjaft e leverdishme, eficente dhe ekonomike për kontrollin ndaj aromave dhe / ose trajtimin e shkarkimeve në ajër që përmbajnë përbërje organike.

Biofiltrat janë të përshtatshëm për aplikimet në industrinë farmaceutike dhe kimike, prodhimimin dhe përpunimin e materialve plastike, bojrat dhe veshje industriale, impiantet e trajtimit të mbetjeve urbane, impiantet e biogazit, industrinë e ushqimit, etj.

DEKONTA ofron:

- Pajisje të kompletuara biofiltër (me celsa në dorë)
- Projektim të biofiltrave
- Prova në shkallë pilot të eficencës së biofiltrave
- Matje, monitorim dhe funksionim të sinkronizuar të biofiltrave
- Shërbime dhe mirëmbajtje e biofiltrave

PAJISJE PËR MBETJET, UJIN DHE TRAJTIMIN E SHKARKIMEVE NË AJËR

DEKONTA ofron pajisjet e mëposhtme për trajtimin e mbjetjeve:

- Impiante të lëvizshme (në kontenierë) stabilizimi dhe ngurtësimi
- Impiante të lëvizshme për larjen e tokës
- Pajisje për kompresim në formë granulare (peleta) të pluhurave dhe llumrave
- Mjete lundruese me paisje për gërmim dhe nxjerrje të llumrave nga uji

DEKONTA ofron pajisjet e mëposhtme për trajtimin e shkarkimeve në ajër:

- Biofiltra (shikoni më lart)
- Filtra adsorbimi me karbon aktiv
- Njësi rigjenerimi të karbonit aktiv

DEKONTA ofron pajisjet e mëposhtme për trajtimin e ujërave të ndotura:

- Bioreaktorë
- Impiante të lëvizshëm në kontenierë (ndarje sipas gravitetit, largimi nëpërmjet fryrjes së ajrit, absorbim)
- Ligatina artificiale (shikoni më poshtë)

LIGATINAT ARTIFICIALE

Ligatinat artificiale paraqesin zgjidhje ekonomike dhe teknologjike eficiente për trajtimin e ujërave të ndotur në fshatra, bashkitë e vogla dhe fabrika.

Ujërat e ndotura shkarkohen në një ligatinë artificiale të kompozuar dhe ndërtuar për këtë qëllim dhe substancat e ndotura largohen nga uji nëpërmjet rrënjëve të disa bimëve të vecanta të rritura në këto ligatina.

DEKONTA ofron:

- Ligatina artificial “me celsa ne dorë”
- Përzgjedhjen e zonës së përshtatshme për ndërtimin e një ligatine artificiale
- Konstruksionin dhe pajisjen me leje për ligatinën artificiale
- Përzgjedhjen, dërgesën dhe zhvillimin e bimëve të përshtatshme për tu rritur në ligatinat artificiale
- Funksionimin dhe mirëmbajtjen e ligatinave artificiale

KLIENTËT

DEKONTA merr me qindra porosi dhe projekte mjedisore cdo vit. Ndër klientët tanë do të përmendim kompani industriale, ndërtimi, organizata ndërkombëtare, banka, sipërmarrës, ministri dhe njësi të qeverisjes vendore:

Lista e klientëve të përzgjedhur:

- Industritë kimike, petrokimike dhe përpunimit të naftës bruto: Unipetrol, Slovnaft, MOL, PKN Orlen, Orlen Lietuva, Hexion, Akzo Nobel, Benzina, Istro-chem
- Energjitikë: E.ON, Jihočeská plynárenská, Západočeská energetika, Transgas
- Metalurgji: US Steel, Feramo, Vítkovice Steel, Mittal Steel
- Industrita Inxhinierike dhe e prodhimit të makinave: ČKD DIZ, GDX Automotive, TRW
- Industria e ushqimit dhe konsumatorit: Královský pivovar Krušovice, DUO, Dermacol, Tesco
- Sipërmarrës: Central Group, Red Group, CEI Building
- Organizata Transporti: Čepro, Mero, Czech Railëays, ČSA, Prague Airport
- Kompani ndërtimi: Skanska, Zakladani staveb, Metrostav, Eurovia
- Ministritë dhe organizatat shtetërore: Ushtria Ceke, Ministria e Financës, Ministria e Industrisë dhe Tregtisë, Ministria e Mjedisit
- Organizata ndërkombëtare: Banka Botërore, Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, NATO, UNDP, UNEP

KONTAKTE

Republika CEKE

DEKONTA, a.s.

Dřetovice (zyra qëndrore)
Dřetovice 109, 273 42 Stehelčeves
tel: +420 312 292 960
fax: +420 312 292 966
e-mail: dretovice@dekonta.cz

Prague (zyrë)
Volutová 2523, 158 00 Praha 5
tel: +420 235 522 252-3
fax: +420 235 522 254
e-mail: info@dekonta.cz

Poloni

DEKONTA - Polska Sp. z.o.o.

Warszawa (zyra qëndrore)
Jagiellonska 76,
Varsavia 03-301, Polska
tel: +48 41 3621882
fax: +48 41 3621882
e-mail: biuro@dekonta.pl

Kielce (zyrë)
Ściegiennego 252, Kielce 25-116,
Polska
tel: +48 41 362 18 82
e-mail: biuro@dekonta.pl

Serbi

DEKONTA d.o.o.
Bulevar Zorana Đinđića 87/4
11070 Belgrado, Serbia
tel: +381 113 017 741
fax: +381 113 111 762
email: office@dekonta.rs

Sllovaki

DEKONTA Slovensko, spol.s r.o.
Odeská 49, 821 06 Bratislava
Slovenská republika
tel/fax: + 421 245 527 672
cel: +421 910 788 321
e-mail: slovensko@dekonta.com

Rusi

DEKONTA Geolink "OOO"
Varshavskoe shosse, 35, building 1 (River Plaza)
117105 Moscoë, Russia
tel: +7 495 380 1680
fax: +7 495 380 1684
e-mail: mail@dekolink.ru

Rumani

DEKONTA SRL
Anul 1848 street, 14
1000559 Ploiesti, Romania
tel: +403 44100284
fax: +403 44100284
e-mail: romania@dekonta.com

Hungari

Dekonta-Öko Kft.
Ostrom u. 27., 1st floor, No. 1
1015 Budapest, Hungary
tel: +420 235 522 252-3
e-mail: hungary@dekonta.com